VENDIM
Nr. 175, datë 6.3.2012

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË LUSHNJË, TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Lushnjë, të qarkut të Fierit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 270 (dyqind e shtatëdhjetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 4 270 (katër mijë e dyqind e shtatëdhjetë).

Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Lushnjë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Lushnjë		Lidhja nr. 1
Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
1-9, 11-24, 26-52	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
53-75	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
170-179	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
240,241,243-245	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
251-254	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën sociale	Në pronësi
255-360	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile	Në pronësi
361,3281-3295,3296-3880	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
362-367	Varreza publike	Në pronësi
440,446	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
448-3280	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim

3930-3933,3936,3938-3942 3944-3950	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim DAMT e qarkut Fier dhe bashkia Lushnjë ka vënë në dispozicion nga kjo bashki sipërfaqen prej 158.58 ha tokë bujqësore në Saravë (pasuria nr.3939, në lidhjen nr.1 të projektvendimit të sipërcituar), sipërfaqen prej 5355 ha tokë bujqësore (pasuritë me nr. 3940 dhe 3941
3934,3935,3937,4051,4055,4057,4059,4061-4063,4065-4068, 4073-4083,4085,4087-4102, 4106, 4112-4115,4117-4119, 4122-4134,4136-4149, 4152, 4154,4157-4161, 4165,4166, 4187-4201,4203	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
368-415,3881-3912,3959-3962	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi